

Në librin pranë jush, në numrin më të madh të rasteve flasim për civilët që e kanë humbur jetën apo janë zhdukur dhunshëm për shkak të abuzimit të së drejtës humanitare ndërkombëtare. Megjithatë, *Libër Kujtimi i Kosovës, Viti 1998*, nuk është një regjistër i viktimave të krimeve të luftës në kuptimin rigoroz juridik, por është regjistër i të gjitha personave që e kanë humbur jetën apo janë zhdukur me dhunë. Rrjedhimisht, ky regjistër i përfshin dëmet civile, nga njëra anë, dhe dëmet ushtarake, nga ana tjetër. Ne nuk kishim për detyrë të përcaktonim statusin juridik të personave që e kanë humbur jetën apo janë zhdukur me dhunë (si luftëtar apo civil), apo kualifikimin juridik të veprës që ka rezultuar me vdekje. Kjo është punë e drejtësisë dhe grupeve të ekspertëve që merren me hulumtimin e statusit juridik të personave që kanë gjetur vdekjen apo janë zhdukur në mënyrë të dhunshme në konfliktet e armatosura apo në lidhje me këto konflikte.

Në rastin e përcaktimit të dëmeve shqiptare në njerëz, kemi hasur në vështirësi serioze lidhur me përcaktimin e dëmeve të UÇK-së në njerëz. Gjatë procedurës së verifikimit të të dhënave, krahasimit të të dhënave që janë siguruar gjatë vitit 1998 dhe janë azhurnuar pesë apo më shumë vjet më vonë, kemi konstatuar se të dhëna [të azhurnuara] të reja e rrisin në një shkallë të madhe numrin e ushtarëve të UÇK-së që kanë rënë apo janë zhdukur gjatë vitit 1998, gjë që ka rezultuar në zvogëlimin e numrit të viktimave civile. Në bazë të të dhënave të reja siç janë për shembull: shpalljet e mëvonshme e personave që e kanë humbur jetën apo janë zhdukur për dëshmorë të luftës; vërtetimet e Shoqatës së Veteranëve të Luftës të UÇK-së se dikush ka qenë pjesëtar i UÇK-së; asistencat sociale për familjet e dëshmorëve; si dhe ndryshimet e deklaratave të familjeve për statusin e anëtarëve të tyre të rënë apo të zhdukur, kemi qenë të detyruar që afro 10 për qind të viktimave të evidentuara paraprakisht si civile t'i ripërcaktojmë si pjesëtarë të UÇK-së. Përpjekja jonë që të përcaktojmë numrin e pjesëtarëve të forcave serbe, UÇK-së dhe civilëve që kanë rënë në betejë (luftëtarë) ka shtruar para nesh dilema të reja. Në mesin e shqiptarëve të rënë kemi identifikuar një numër të konsiderueshëm civilësh që i bashkëngjiteshin UÇK-së në mbrojtjen e fshatit apo turmave të refugjatëve dhe, pas tërheqjes së forcave serbe, i ktheheshin jetës së përditshme, duke pësuar gjatë sulmeve të reja ndaj fshatrave të tyre si luftëtarë në anën e UÇK-së. Për familjarët e tyre, ata janë luftëtarë, në përmendoret ata gjenden në uniformë ushtarake, ndërkaq komuniteti lokal i respekton si luftëtarë dhe mbrojtës të Kosovës. Edhe ne e kemi pranuar këtë qasje, edhe pse argumentet juridike qëndrojnë në anën e komentimit, i cili civilët që marrin pjesë në mbrojtjen e fshatit i konsideron dhe u jep statusin e civilit.

Në rastin e pjesëtarëve të forcave serbe, kemi regjistruar disa raste të pësimit, të cilat MPB-ja dhe UJ-a ia atribuojnë UÇK-së, ndërkaq FDH ka gjetur se deri te vdekja ka ardhur si pasojë e rasteve aksidentale apo në ndonjë mënyrë tjetër, që e përjashton përgjegjësinë e palës kundërshtuese në konflikt. Edhe në mesin e civilëve serb ka një numër të konsiderueshëm të atyre që marrin pjesë në mbrojtjen e fshatit dhe që pësojnë në luftime, gjatë sulmeve të UÇK-së ndaj fshatrave dhe shtëpive të tyre. Por, familjet e tyre flasin për ta sikur për civilë. Nuk ka prova se dikush nga ta është shpallur më vonë luftëtar.

Tendencat e sipërpërmendura kërkojnë debate dhe analiza të hollësishme juridike dhe sociologjike. Vetëm ato mund të ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve që paraqiten lidhur me statusin juridik të personave që e kanë humbur jetën apo janë zhdukur në mënyrë të dhunshme.

Detyra jonë është që familjeve, publikut, hulumtuesve, ekspertëve dhe gjeneratave të ardhshme tu ofrojmë informata dhe fakte të provuara për rrethanat në të cilat saktësisht 2.001 qytetarë,